

## **Deklaratë për median**

### **Shpërblimi dëmi për familjen e komunitetit Rom si pasojë e prishjes së banesës familjare**

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë i ka njohur një familjeje nga komuniteti Rom të drejtën e shpërblimit të dëmit nga Bashkia Tiranë dhe Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit në shumën 2,153,200 lekë si dhe dëmin moral të shkaktuar në vlerën 150,000 lekë. Nëpërmjet punës së përkushtuar të avokatëve të CLE të cilët ndjekin procesin gjyqësor prej vitit 2016, Gjykata i konsideroi në shkelje të ligjit veprimet e organeve publike të cilat prishën banesën e kësaj familjeje për shkak të ndërtimit të “Unazës së Madhe” dhe nuk i njohën të drejtën e shpronësimit.

Banesa ishte ndërtuar përpara vitit 1991 pranë segmentit rrugor Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës. Në vitin 2016 në këtë segment rrugor do të nisnin punimet për ndërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës. Kjo familje pasi mori dijeni për ndërtimin e segmentit rrugor që pritej të fillonte dhe do të prishte shtëpitë e tyre, aplikoi pranë Bashkisë Tiranë në përputhje me kriteret e VKM Nr. 608 datë 05.09.2012, për të fituar pronësinë dhe për pasojë të përfitonte në vijim nga procedura e shpronësimit.

Bashkia Tiranë njoftoi ARSH-në që aplikuesi nuk kualifikohej dhe nuk plotësonte kriteret për tu njohur pronar, dhe duke u bazuar në shkresën e Bashkisë Tiranë, Autoriteti Rrugor Shqiptar i kërkoi Inspektorati Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) të ndërhynte për të liruar sheshin e ndërtimit nga objektet. Shtëpia e banimit të tij u prish nga aksioni i IKMT-së në datat 18.02.2016 e 19.02.2016 dhe familja mbeti e pastrehë duke u dëmtuar ekonomikisht, sepse humbën investimin e gjithë jetës dhe duke pësuar një ngarkesë e madhe emocionale dhe psikologjike. Kjo familje kontaktoi me avokatët e Klinikave të Ligjit (sot Centre for Legal Empowerment), të cilët treguan gatishmërinë për ta përfaqësuar pranë Gjykatës.

CLE është duke ndjekur pranë Gjykatës së Apelit edhe rastet e dy familjeve të tjera nga komuniteti Rom, të cilëve Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë i ka njohur respektivisht të drejtën e shpërblimit të dëmit në shumat 5,596,555 Lekë dhe 3,785,000 Lekë.